

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. _____ prot

Datë 22.02.2021

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "VASHTEMI" Sh.p.k , adresa Rruga Nacionale Korçë Pogradec, Km. i 7, Libonik Vashtëmi Korçë + "ARTYKA II" Sh.p.k, adresa Rruga e Mirasit, Km.i I, pranë Ish Nyjes së Inerteve, Bilisht.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur" me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-82294-12-16-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të përdorura në rrugët 'Kajo Karafili', 'Fore Çunoti' etj në qytetin e Korçës, si dhe në disa rrugë në fshatrat Drenovë dhe Boboshticë në NJ.A. Drenovë."

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 122 datë 21.12.2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "INA" SH.P.K, NIPT: J61814009V, vlera: 6.815.928 (gjashtëmilionetëqindpesëmbëdhjetëmijëenëntëqindnjëzetetë) lekë.
2. "A.L-ASFALT" Sh.p.k, NUIS: K81511508A , vlera: 7.168.770 (shtatëmilionenjëqindgjashtëdhjetëetëmijëeshtatëqindeshtatëdhjetë) lekë.
3. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "VASHTEMI" SH.P.K NIPT:J64103054Q + "ARTYKA II" Sh.p.k NIPT: K26625603U, vlera: 7.880.670 (shtatëmilionetëqindetëdhjetëmijëegjashtëqindeshtatëdhjetë) lekë.
4. "NIKA" Sh.P.K , NUIS: J76705047U, vlera: 8.172.667,13 (tetëmilionenjëqindeshtatëdhjetëedymijëegjashtëqindgjashtëdhjetëeshtatëpresjetrembëdhjetë) lekë.
5. "ALB KORCA 2002" Sh.p.k, NIPT: K34004003T, vlera: 8.312.063 (tetëmilionetreqindedybëdhjetëmijëegjashtëdhjetëetë) lekë
6. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "XHENGO" SHPK, NUIS:J64103171M , + "CURRI" Sh.p.k, NUIS: J67902718S, vlera: 8.485.037 (tetëmilione katër qindetëdhjetëepesëmijëetridhjetëeshtatë) lekë.
7. "K.M.K" sh.p.k, NIPT: L78223801E, vlera: 10.257.597 (dhjetëmiliondyqindpesëdhjetëeshtatëmijëepesëqindenëntëdhjetëeshtatë) lekë.
8. "BOSHNJAKU.B" SH.P.K, NIPT: K72627402H, vlera: 11.544.047 (njëmbëdhjetëmilione pesëqindedyzetekatërmijëedyzeteshtatë) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "A.L-ASFALT" Sh.p.k, NUIS: K81511508A , vlera: 7.168.770 lekë.
2. "NIKA" Sh.P.K , NUIS: J76705047U, vlera: 8.172.667,13 lekë.
3. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "XHENGO" SHPK, NUIS:J64103171M , + "CURRI" Sh.p.k, NUIS: J67902718S, vlera: 8.485.037 lekë.
4. "INA" SH.P.K, NIPT: J61814009V, vlera: 6.815.928 lekë.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

➤ Lidhur me operatorin ekonomik "A.L-ASFALT" Sh.p.k, KVO, në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Nenit 66, pika 3, si dhe të Rekomandimit të APP-së Nr.8197 prot, datë 03.09.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime" vendosi unanimitisht që ofertuesi "A.L-ASFALT" Sh.P.K të mos kualifikohet sepse:

1. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 2, Shtojca 12 e DT, sepse nuk paraqiti Deklaratë (nga Administratori i shoqërisë), me anë të së cilës të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve.

2. Ofertuesi nuk përmbush Kriterin e veçantë teknik të kualifikimit, pika 4, Shtojca 12 e DT, sepse nuk paraqiti Deklaratë për përmbushjen e volumeve të gërmimit me krahë, duke punësuar minimalisht 4 punëtorë.

Ofertuesi paraqiti një Deklaratë që do të punësonte të paktën minimalisht 4 punëtorë për përmbushjen e volumeve të gërmimit me krahë, për Autoritetin Kontraktor Bashkinë Krujë, për objektin "Shëmbja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimi i materialeve të dala nga shëmbja e tyre, në kuadër të procesit të rindërtimit", me datë të zhvillimit të tenderit 21.01.2021.

3. Ofertuesi nuk përmbush numrin total prej 7 personash të kërkuar manovratorë dhe shoferë, sipas pikave 7 dhe 8, të Shtojcës 12 të DT, tek Kriteret e veçanta teknike të kualifikimit (janë kërkuar 5 manovratorë dhe 2 shoferë), kjo për arsye se ofertuesi paraqiti dy Kontrata pune (gjithashtu dhe Dëshmi e afësisë profesionale për përdoruesit e mjeteve të rënda; leje drejtimi) për punonjës in Arlin Lila, si manovrator dhe njëkohësisht si shofer. Pra në total dëshmoi se ka 6 persona manovratorë dhe shoferë.

➤ Lidhur me operatorin ekonomik "NIKA" Sh.p.k, KVO, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, Nenit 53, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me ndryshime nenit 66 pika 4, të Udhëzimit të APP-së, datë 18.02.2009 "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike", të DT- Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë pika 3.2, vendosi unanimitisht që oferta e "NIKA" Sh.P.K të refuzohet sepse:

1. Oferta rezulton me një gabim aritmetik në vlerën e përgjithshme tek Formulari i ofertës si dhe tek Preventivi përmbledhës pasi është ofruar vlera e gabuar 8.172.667,13 lekë, kundrejt vlerës të saktë prej 7.783.492,5 lekë sepse fondi rezerve 5% është llogaritur dy herë. Gabimi rezulton të jetë +5%.

Për këtë arsye, sipas përcaktimit të dispozitave ligjore të sipërcituar, oferta me gabime aritmetike refuzohet, sepse shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

➤ Lidhur me Bashkimin e Operatorëve Ekonomike "XHENGO" SHPK + "CURRI" Sh.p.k, KVO, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" me ndryshime, Nenit 53, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me ndryshime nenit 66 pika 4, të Udhëzimit të APP-së, datë 18.02.2009 "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike", të DT- Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë pika 3.2, vendosi unanimitisht që oferta e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike "XHENGO" SHPK + "CURRI" Sh.p.k të refuzohet sepse:

1. Oferta rezulton me një gabim aritmetik në vlerën e përgjithshme tek Formulari i ofertës si dhe tek Preventivi përmbledhës pasi është ofruar vlera e gabuar 8.485.037 lekë, kundrejt vlerës të saktë prej 8.099.354 lekë. sepse fondi rezerve është llogaritur dy herë. Gabimi rezulton të jetë + 4,76 %.

Për këtë arsye , sepse përcaktimit të dispozitave ligjore të sipërcituar, oferta me gabime aritmetike refuzohet, sepse shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

➤ Lidhur me ofertuesin "INA" Sh.p.k , KVO , në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime, Nenit 56, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ndryshime nenit 66 , si dhe të Udhëzimit të APP-së, datë 18.02.2009 “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”, unanimisht vendosi që oferta e "INA" Sh.p.k të refuzohet **sepse për çmimin anomalisht të ulët të ofruar, ofertuesi nuk arriti të japë një justifikim që të bindë KVO.**

Për ofertën anomalisht të ulët , KVO i ka kërkuar ofertuesit, analizë teknike të argumentuar dhe të dokumentuar me prova shkresore për të justifikuar , ndër të tjera, çmimet për zërat : Tek Preventivi i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në Rrugët "Kajo Karafili", "Fore Çunoti" etj. (Lagjia 5 dhe 13) , zërat :

Nr.	Nr. Analize	Emertimi i Punimeve
4	3.An/2t	Furnizim vendosje tub korrugato HDPE,SN8. DN400. ID
5	3.An/1t	Furnizim vendosje tub korrugato HDPE, SN8. DN300. ID
10	An-21	Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize

Tek Preventivi i ndërtimit të linjës së kanalizimit në fshatin Boboshticë, zërat :

Nr.	Nr. Analize	Emertimi i Punimeve
2	3.An/1t	F,V tubo te brinjezuar HDPE, SN8, DN315
6	An-21	Puseta shkarkimi b/a,1x1x1.5m,me kapak gize

Tek Preventivi i ndërtimit të linjës së kanalizimit në fshatin Drenovë, zërat :

Nr.	Nr. Analize	Emertimi i Punimeve
2	3.An/1t	Furnizim vendosje tub korrugato HDPE,SN8. DN300
6	An-21	Puseta shkarkimi b/a,1x1x1.5m,me kapak gize

KVO ka verifikuar elementët (zërat) mësipër, **në bazë të informacionit të paraqitur nga "INA" Sh.p.k** (në datën 29.01.2021 nëpërmjet SPE, si dhe informacionit të njëjtë të ridërguar nëpërmjet postës në datën 01.02.2021) .

KVO vendos ta refuzojë ofertën sepse edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi , nuk bindet se oferta është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Konkretisht :

- I. Ofertuesi nuk arrin të justifikojë çmimin e ofruar prej 11.200 leke për zërin :
 1. Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize, sasia 12 copë, tek Preventivi i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në Rrugët "Kajo Karafili", "Fore Çunoti" etj. (Lagjia 5 dhe 13), zëri nr. 10;
 2. Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize, sasia 8 copë, tek Preventivi i ndërtimit të linjës së kanalizimit në fshatin Boboshticë, zëri nr. 6;

3. Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize, sasia 13 copë, tek Preventivi i ndërtimit të linjës së kanalizimit në fshatin Drenovë, zëri nr. 6;

Së pari: Për të justifikuar çmimin njësi të ofruar prej 11.200 lekë, ofertuesi ka paraqitur një faturë tatimore shitje nr. 1309, datë 03.07.2020, e cila dëshmon se "INA" Sh.p.k ka blerë nga shitësi "ARJEIL" Sh.p.k, 5 copë "Puseta 100x100" me çmim 4.167 leke/copë, si dhe 5 copë "Kapakë 100x100" me çmim 2.500 leke/copë.

Nga ky informacion i paraqitur nga "INA" Sh.p.k, KVO nuk bindet sepse kjo faturë nuk dëshmon se pusetat e blera janë **puseta prej betoni të armuar** b/a dhe sepse kjo faturë nuk dëshmon përmasën e lartësisë 1.5 m.

Gjithashtu nga ky informacion i paraqitur nga "INA" Sh.p.k, KVO nuk bindet sepse kjo faturë **nuk dëshmon se kapakët e pusetave të blera janë kapakë prej gize** dhe kanë lartësi 100 mm, lartësi kjo e kërkuar në specifikimet teknike Shtojca 13 me ndryshime e DT.

Për pasojë ky informacion kjo faturë e paraqitur nuk arrin të bindë KVO, që "INA" Sh.p.k mund të ofrojë "Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize" (33 copë në total) sipas specifikimeve teknike të kërkuara , me çmimin shumë të ulët të pusetës 4.167 leke/copë dhe me çmimin shumë të ulët të kapakëve të pusetave 2.500 leke/copë.

Çmimi anomalisht i ulët 4.167 leke/copë dhe 2.500 leke/copë, nuk u arrit të justifikohet në mënyrë bindëse, që ishte një çmim real tregu për Pusetat **sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DT.**

KVO nuk arrin të bindet që do të ofrohen puseta, në përputhje me **specifikimet teknike të kërkuara në DT** dhe jo puseta me cilësi më të ulët , me çmimin shumë të ulët të ofruar 4.167 leke/copë pusetë dhe 2.500 leke/copë kapak pusete.

Theksojmë se bindja e KVO rreth justifikimeve të çmimeve, krijohet dhe bazohet , në infomacionin e paraqitur nga "INA" Sh.p.k.

Së dyti: Për të justifikuar çmimin e ofruar prej 11.200 leke, ofertuesi ka paraqitur dhe një Analizë teknike të bazuar në VKM Nr.629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Nga ky informacion i paraqitur nga "INA" Sh.p.k, KVO nuk bindet që "INA" Sh.p.k mund të ofrojë "Puseta shkarkimi b/a, 1x1x1.5m, me kapak gize", me çmimin njësi shumë të ulët prej 11.200 lekë sepse konkretisht :

1. Sipas Analizës teknike , për "Kapak gize 100x100 Ø 60 cm" , ofrohet çmimi 40 lek/kg, që është një çmim i zvogëluar shumëfish, krahasuar me Manualin VKM Nr.629, datë 15.07.2015.

2. Sipas Analizës teknike , për punimet e betonit "Shtrese beton C12/15 " dhe "Mur betoni C12/15 ", ofrohet çmimi 4.000 lek/m³, që është një çmim shumë i zvogëluar, krahasuar me Manualin VKM Nr.629, datë 15.07.2015.

3. Sipas Analizës teknike , orët e punës për specialistët + punëtori (paraqiten 2 orë pune), janë zvogëluar më tepër se 4 herë, krahasuar me analizën teknike të Manualit VKM Nr.629, datë 15.07.2015.

Gjithashtu, sipas Analizës teknike , orët e makinerive janë ulur, krahasuar me analizën teknike të Manualit VKM Nr.629, datë 15.07.2015.

4. Sipas Analizës teknike , transporti i dheut + te ndryshme , në T km , është ulur 4-fish, krahasuar me analizën teknike të Manualit VKM Nr.629, datë 15.07.2015 .

Pra fakti që çmimet e pasqyruara në Analizën teknike të "INA" Sh.p.k, nuk përputhen me çmimet e Manualit teknik zyrtar dt.15.07.2015, krijojnë mosbindje tek KVO, që çmimi anomalisht i ulët 11.200 lekë , mund të jetë një çmim tregu i justifikuar real.

Gjithashtu konstatohet se nuk figuron e përlogaritur vlera e armimit të pusëtës bazuar në specifikimet teknike.

II. Ofertuesi nuk arrin të justifikojë çmimin e ofruar prej 1.850 leke për zërin : "Furnizim vendosje tub korrogato HDPE,SN8. DN400", sasia 100 ml, tek Preventivi i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në Rrugët "Kajo Karafili", "Fore Çunoti" etj. (Lagjia 5 dhe 13), zëri nr. 4.

Për të justifikuar çmimin njësi të ofruar prej 1.850 lekë, ofertuesi ka paraqitur një faturë tatimore shitje nr. 172, datë 14.07.2020, e cila dëshmon se "INA" Sh.p.k ka blerë nga shitësi "ABO- JA" Sh.p.k, 75 ml "Tubo korrogato Ø400 " me çmim 1.000 leke/ml.

Nga ky informacion i paraqitur nga "INA" Sh.p.k, KVO nuk bindet sepse kjo faturë nuk dëshmon se tubot e blera janë tubo të klasës SN 8 (8 KN/m²) sepse në faturë nuk paraqitet një e dhënë e tillë.

Për pasojë ky informacion kjo faturë e paraqitur nuk arrin të bindë KVO, që "INA" Sh.p.k mund të ofrojë "Tubo korrogato Ø400", në përputhje me **specifikimet teknike të kërkuara në DT** , pra që të jenë jo thjesht Tubo korrogato Ø400 HDPE, por Tubo korrogato Ø400 HDPE të klasës SN 8.

KVO nuk arrin të bindet që do të ofrohet çmimi anomalisht i ulët 1.850 lekë/ml, për tubo Ø400 SN 8 , dhe jo për tubo me cilësi më të ulët.

Edhe tek analiza teknike e zërit "Furnizim vendosje tub korrogato HDPE,SN8. DN400", çmimi i Tubo korrogato Ø400 i referohet çmimit të furnizimit të faturës tatimore të shitjes nr. 172, datë 14.07.2020, e cila pra nuk dëshmon që tubot korrogato Ø400, të jenë të klasës SN 8.

III. Ofertuesi nuk arrin të justifikojë çmimin e ofruar prej 1.100 leke për zërin : "F,V tubo te brinjezuar HDPE, SN8, DN 315", sasia 140 ml, tek Preventivi i ndërtimit të linjës së kanalizimit në fshatin Boboshticë, zëri nr. 2.

Për të justifikuar çmimin njësi të ofruar prej 1.100 lekë, ofertuesi ka paraqitur një faturë tatimore shitje nr. 202, datë 27.07.2020, e cila dëshmon se "INA" Sh.p.k ka blerë nga shitësi "ABO- JA" Sh.p.k, 36 ml "Tubo korrogato Ø 315 " me çmim 525 leke/ml.

Nga ky informacion i paraqitur nga "INA" Sh.p.k, KVO nuk bindet sepse kjo faturë nuk dëshmon se tubot e blera janë tubo të klasës SN 8 (8 KN/m²) sepse në faturë nuk paraqitet një e dhënë e tillë.

Për pasojë ky informacion kjo faturë e paraqitur nuk arrin të bindë KVO, që "INA" Sh.p.k mund të ofrojë "Tubo korrogato Ø315", në përputhje me **specifikimet teknike të kërkuara në DT** , pra që të jenë jo thjesht Tubo korrogato Ø315 HDPE, por Tubo korrogato Ø315 HDPE të klasës SN 8.

KVO nuk arrin të bindet që do të ofrohet çmimi anomalisht i ulët 1.100 lekë/ml, për tubo Ø315 SN 8, dhe jo për tubo me cilësi më të ulët.

Përsa i përket analizës teknike , tek Analiza teknike e paraqitur nga "INA" Sh.p.k, nuk jepet asnjë analizë teknike për zërin " F,V tubo te brinjezuar HDPE, SN8, DN 315".

IV. Ofertuesi nuk arrin të justifikojë çmimin e ofruar prej 1.100 leke për zërin : ”Furnizim vendosje tub korrugato HDPE, SN8. DN300 ”, sasia totale 1.790 ml, tek Preventivi i ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në Rrugët "Kajo Karafili", "Fore Çunoti" etj. (Lagjia 5 dhe 13), zëri nr. 5; si dhe tek Preventivi i ndërtimit të linjës së kanalizimit në fshatin Drenovë, zëri nr. 2.

Për të justifikuar çmimin njësi të ofruar prej 1.100 lekë, ofertuesi "INA" Sh.p.k ka paraqitur vetëm një analizë teknike , por ofertuesi nuk ka paraqitur ndonjë faturë tatimore shitje të mundshme , e cila dëshmon se "INA" Sh.p.k mund të ketë blerë Tubo korrogato Ø 300 SN8, me këtë çmim anomalisht të ulët.

KVO nuk arrin të bindet që do të ofrohet çmimi anomalisht i ulët 1.100 lekë/ml, për tubo Ø300 SN 8 , dhe jo për tubo me cilësi më të ulët.

”Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementet e veçanta të ofertës.”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike ”VASHTEMIJA” Sh.p.k adresa Rruga Nacionale Korçë Pogradec, Km. i 7, Libonik Vashtëmi Korçë + ”ARTYKA II” Sh.p.k, adresa Rruga e Mirasit, Km.i I, pranë Ish Nyjes së Inerteve, Bilisht, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7.880.670 (shtatëmilionetëqindetëdhjetëmijëegjashtëqindeshtatëdhjetë) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKKO Sh.A, adresa Rajoni Nr. 1, Rruga Boris Plumbi, Korçë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda dhjetë ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 8.312.063 (tetëmilionetreqindetëdhjetëmijëegjashtëdhjetëetë) lekë, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.02.2021.

Ankesa: ka.

Në datën 09.02.2021, AK ka marrë një ankesë nga ofertuesi "INA" Sh.p.k, i cili është ankuar për Vendimin e KVO datë 08.02.2021, për moskualifikimin e tij.

Ankesa ka marrë përgjigje në datën: 11.02.2021.

Me Vendimin nr. 50 /1 Prot, datë 11.02.2021, Komisioni i shqyrtimit të ankesës, vendosi Refuzimin e Ankesës të "INA" Sh.p.k dhe lënien në fuqi të Vendimit të KVO Nr. 11 /1 Prot, datë 08.02.2021.

* * *

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Elia Pendavinji